



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
Up1 Nr.03-125
15.04.2022
Sh k u p

Bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), lidhur me nenin 53 paragrafi 5 dhe paragrafi 17 alinea 2 nga i njëjti Ligj, pika 4 nga Udhëzuesi për përcaktimin e afatit për të vepruar sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-6039/1 nga 20.10.2015, Raporti me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1281/1 nga 29.03.2022 dhe Konkluzën ark.nr.02-1682/6 nga 15.04.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në seancën e 15-të e mbajtur më 15.04.2022, miratoi si në vijim:

Vendim
për shqiptim të masës – vërejtje publike

1. VËREJTJE PUBLIKE ndaj Shoqëris tregtare radiodifuzive (SHTR) KANAL 5 SHPKPV Shkup, për shkelje të nenit 53 paragrafi 5 dhe paragrafi 17 alinea 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (LSHMAAV), në mënyrë që në kornizat e shërbimit programor televiziv më datë 21, 22 dhe 23 shkurt 2022., ka transmetuar spot reklamues dhe spot tele-shopping për „Bronho protekt-500ml.“ dhe spot tele-shopping për „Diabetol forte-30 kapsula“, nga operatori për ushqim „Natura terapi“ SHPKPV Shkup, në të cilën paraqitet në mënyrë të përgënjeshtuar natyra dhe karakteristikat e produktit, dmth komunikimet komerciale audiovizuele janë të pavërteta dhe të pandershme, duke mashtruar kështu opinionin dhe janë kundër interesave të konsumatorit.

Shkelje e paragrafit 1 e kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1281/1 nga 29.03.2022., e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi si Shtojcë nr.1.

2. OBLIGOHET SHTR KANAL 5 SHPKPV Shkup, menjëherë pas pranimit të Vendimit, të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i paraqitur në pikën 1 të këtij Vendimi, veproi sipas Vendimit.

4. Ky Vendim është i formës së prerë, dhe si ditë e miratimit të tij konsiderohet dita e verifikimit në arkivën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia bazuar në nenin 28 nga LSHMAAV ka kompetenca të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetojnë operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik duke respektuar dispozitat e Ligjit, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akteve të tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë miratoi masë-vendim për vërejtje publike në pajtim me Ligjin, në rast të shkeljes së dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara nga po i njëjti ligj, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akteve të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 53 paragrafi 5 nga LSHMAAV, ndalohen komunikimet komerciale audiovizuele që do të keqinterpretojnë natyrën, karakteristikat, kualitetin ose origjinën gjeografike të

produkteve, shërbimet ose veprimtarinë e shërbimit. Në nenin 53 pragrafi 17 alinea 2 është përshkruar se komunikimet komerciale audiovizuale duhet të jenë të vërteta dhe të ndershme, të mos mashtrojnë publikun dhe të mos jenë në kundërshtim me interesat e konsumatorit.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 28 mars 2022., ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore (monitorim) ndaj shërbimit programor televiziv të SHTR KANAL 5 SHPKPV Shkup, të transmetuar më datë 21, 22 dhe 23 shkurt 2022., në nivel shtetëror, ku konstatoi shkelje të nenit 53 paragrafi 5 dhe paragrafi 17 alinea 2 nga LSHMAAV. Mbikëqyrja e jashtëzakonshme u realizua pas njoftimit nga Agjencia për ushqim dhe veterinarin (AUV) për komunikime komerciale audiovizuale të paligjshme për shtesa ushqimore, në kuadër të Memorandumit për bashkëpunim përmes ASHMA-së dhe AUV-së, lidhur më 14.04.2021.

Shkelje është vërejtur në spotin reklamues dhe spotin tele-shopink për (suplimentin) shtesën ushqimore „Bronho protekt – 500ml.“ („Broncho protect-500ml.“) dhe për ushqimin me destinim të veçantë (nutritiv) për qëllime mjekësore, „Diabetol forte – 30 kapsula“ („Diabetol forte“), të operatorit për ushqim „Natura terapi“ SHPKPV Shkup, e ritransmetuar më datë 21, 22 dhe 23 shkurt 2022., ku janë shfrytëzuar materiale vizuale dhe thënie verbale që sugjerojnë pohime shëndetësore ose ushqimore (nutritive), si dhe deklarime të produkteve që nuk janë miratuar nga Agjencia për ushqim dhe veterinarin. Në spotin reklamues dhe spotin tele-shopink na prezantohet me përgënjeshttrim natyra dhe karakteristika e produkteve „Bronho protekt – 500ml.“ dhe „Diabetol forte – 30 kapsula“, dmth nuk janë të vërteta dhe të ndershme, mashtrojnë publikun dhe janë kundër interesave të konsumatorit.

Shkelja e pikës 1 e Vendimit, është e specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1281/1 nga 29.03.2022., si pjesë plotësuese e këtij Vendimi si Shtojcë nr.1. Konstatimet në Raport janë bazuar në analizat eksperte mbi llojet e komunikimit komercial audioviziv të regjistruara me monitorimin e këtij shërbimi programor, e punuar nga Agjencia për ushqim dhe veterinarin, si organ kompetent për kryerjen e veprimtarive në fushën e sigurisë ushqimore (nr.i yni ark.nr.03-1183/1 nga 24.03.2022.), bashkangjitur Raportit me shkrim.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 3 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtor SHTR KANAL 5 SHPKPV Shkup më 29.03.2022., dërgoi Shkresë i yni Up1 nr.10-1281/2 nga 29.03.2022., me të cilën ka dorëzuar Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1281/1 nga 29.03.2022., ku në afat kohor prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzojë deklaratë me shkrim për shkeljen e bërë ndaj dispozitave në LSHMAAV. Në afatin e paraparë, SHTR KANAL 5 SHPKPV Shkup nuk dha deklaratë për shkeljen e dispozitave në Ligj. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 15.04.2022., shqyrtoi lëndën e Raportit me shkrim dhe konkludoi ndaj SHTR KANAL 5 SHPKPV Shkup shqiptim të masës – vërejtje publike.

Duke pasur parasysh nga sa u tha më lartë, bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 53 paragrafi 5 dhe paragrafin 17 alinea 2 nga i njëjti Ligj, pika 4 i Rregullores për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimit të Agjencisë për shqiptim të masës, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1281/1 nga 29.03.2022. dhe Konkluzioni ark.nr. 02-1682/6 nga 15.04.2022., për konstatim të mosrespektimit të dispozitave nga LSHMAAV, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Vendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 15.04.2022., miratoi Vendim për vërejtje publike ndaj SHTR KANAL 5 SHPKPV Shkup dhe u obligua, menjëherë pas pranimit të Vendimit, të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e LSHMAAV. Të kryehet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, nga pika 1 i këtij Vendimi, ka vepruar sipas Vendimit.

Në pajtim me nenin 24 nga LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër tij transmetuesi mund të ngrejë padi për kontest administrativ pranë gjykatës kompetente. Padi për kontest administrativ duhet të paraqesë në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Bazuar në sa u tha më lartë, u miratua vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për shërbime mediatike
audio dhe audiovizuale,**

Kryetar i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI d.v

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi transmetuesi mund të ngrejë padi për kontest administrativ pranë gjykatës kompetente. Padi për kontest administrativ paraqitet në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Shtojca (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1281/1 nga 29.03.2022.

Dorëzuar tek:

- SHTR KANAL 5 SHPKPV Shkup;
- Administratori të SHTR KANAL 5 SHPKPV Shkup;
- Personit përgjegjës të programit në SHTR KANAL 5 SHPKPV Shkup;
- Sektori për çështje juridike dhe prokurim publik;
- Sektori për çështje programore; dhe
- Personat e autorizuar në Agjenci për udhëheqjen e regjistrit Up1.